

URDHËR
Nr. 3, datë 15.1.2016

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla.
2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Kuvendin e Shqipërisë, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla për procedurat e prokurimit mbi vlerën e ulët monetare. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Administrativ të këtij institucioni, znj. Etleva Zeqo, për procedurat e prokurimit nën vlerën e ulët monetare.
3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2016.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta